



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Kuvendi i Kryeqytetit -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT

i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Barazi Gjinore, mbajtur
më 19.12.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Violeta Salihu, Besart Krasniqi, Leonora Shabani – Bajraktari dhe Dhurata Jahaj -Retkoceri.

Mungoi: Gëzim Mehmeti.

E pranishme ishte edhe Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore dhe Granit Makolli, përfaqësues nga Drejtoria e Sportit..

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Violeta Salihu**, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

Rend të ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Barazi Gjinore;
2. Diskutim rreth përgatitjes së Planit të punës për vitin 2023,(priten rekomandime nga anëtarët e tjera të komitetit për ta plotësuar këtë plan);
3. Rëndësia e përkrahjes së klubeve të vajzave në sport;
4. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Barazi Gjinore

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Barazi Gjinore.

Pika e dytë

Rëndësia e përkrahjes së klubeve të vajzave në sport

Violeta Salihu, kryesuese tha se sa i përket përkrahjes së klubeve të vajzave, mendoj se kur të jepen subvencionet duhet të jepen me njëfarë rregulli, me një rregullore të shfrytëzimit të atyre mjeteve. Përderisa klub i nuk ja u paguan as transportin në shumicën e rasteve vajzave kur udhëtojnë jashtë Prishtinës, kur humbin ndeshjen nuk ua paguan drekën, kur fitojnë ja u paguajnë, pra është një e

Faqe 1 nga 4

vërtetë se ato shpesh mbesin në mëshirën e fatit si do të kthehen prej ndeshjes kur janë në qytete të tjera.

Granit Makolli, përfaqësues nga Drejtoria e Sportit tha se ne si Drejtori e Sportit buxhetin e kemi të ndarë në atë mënyrë që ti subvencionojmë në dy fazat klubet sportive ku ka qenë një shumë përafërsisht 5 mijë euro dhe janë përkrahur dy herë, kështu që drejtoria ka analizuar se cilat janë ato klube më me prioritet dhe të subvencionohen. Në subvencionim nuk është paraparë ushqimi, pra faturat e ushqimit nuk pranohen, ndërsa në transport ne i përkrahim me mjete financiare.

Violeta Salihu, kryesuese tha se në mesin e vajzave sportiste ka pakënaqësi rrëth ndarjes së mjeteve kështu që ato mjete asnjëherë nuk jepen në mënyrë të rregullt.

Dhurata Jahaj-Retkoceri, kërkoi të dijë se a ka ndonjë organ mbikëqyrës rrëth ndarje së këtyre mjeteve financiare.

Granit Makolli tha se ne kemi edhe organ mbikëqyrës, mirëpo ne si drejtori kemi një staf shumë të vogël kështu që edhe ata nuk kanë të drejtë të dalin nëpër teren.

Violeta Salihu, kryesuese tha se me të vërtetë është shqetësuese fakti që ato vajza të cilat humbin lojën nuk ju paguhet ushqimi si dhe transportin nuk e kanë të sigurt, kështu që kjo përmua është tejet shqetësuese.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se ne si komitet duhet të angazhohemi dhe të ndikojmë tek drejtoria që mjetet financiare në mënyrën më të mirë ti dërgojmë në vendin e duhur, ku përkrahen sidomos vajzat e reja, ku ne i stimulojmë që ato të merren me sport. Ne duhet ta ngritim zërin që mos të manipulohet me vajzat tona. Angazhimi i tyre në sport gjithsesi do të ishte më se e nevojshme përmoshën që e kanë ato. Është mirë që ne të bëjmë diçka si barazi gjinore, ta ngritim zërin në media dhe të flasim sa më shumë.

Violeta Salihu, kryesuese po ashtu tha se kur nënshkruhet një kontratë përmes ajo bëhet obligative që të përbushet, prandaj pse mos të përbushet, ato vajza sportiste janë të reja, duhet të stimulohen përmes arritur suksese.

Granit Makolli, gjithashtu ceku se klubet sportive kërkojnë mjete financiare përmes gara, pagesa përmes referat, përmes sallës, transport, etj.

Dhurata Jahaj-Retkoceri tha se gjithsesi duhet të jetë një organ mbikëqyrës të dihet se ku shkojnë ato mjete dhe si shpenzohen ato, por në realitet kuptohet se ndonjëri prej sportistëve po ka imunitet që e ka babanë biznesmen kështu që anashkalohen të tjerët e që ndoshta janë më të talentuar. Gjithashtu do të ishte mirë që të shikohet se si i ka politikat një klub, a ndryshon prej klubit në klub politika, a e kanë një ligj të njëjtë.

Violeta Salihu, kryesuese tha se do tē ishte mirë që ne si komitet tē jemi prezent një ditë që ti përcjellim ushtrimet sportive që i bëjnë ato vajza , kështu që edhe ato tē jenë nē dijeni se po përkrahen. Po ashtu kérkoi tē dijë se klub i vajzave tē futbollit a përkrahet sikurse klub i djemve, pasi që më parë ka pasur dallime tē mëdha. Gjithkund është e paraparë me rregull që ti sigurojnë ushqimin dhe transportin që ato vajza tē kthehet nē shtëpi.

Lidhur me pyetjet dhe disa shqetësimet tē ngritura nga anëtarët e komitetit, sqarime tē nevojshme dha Granit Makolli, përfaqësues nga Drejtoria e Sportit.

Pika e tretë

Diskutim rreth përgatitjes së Planit tē punës pér vitin 2023,(priten rekomandime nga anëtarët e tjerë tē Komitetit pér ta plotësuar këtë plan)

Violeta Salihu, kryesuese tha se ne planin e punës e kemi pasur prej muajit gusht, kështu që tani ne duhet tē mendojmë se si tē jetë plani i ardhshëm pér vitin 2023, ku dhe do ti marrin edhe disa rekomandime nga anëtarët e komitetit. Pra se tē fillojmë me hartimin e këtij plani, mendoj se do tē ishte mirë që tē takohemi me institucionet që e parandalojnë dhunën, pra që tē kemi informata rreth kësaj çështjeje.

Premtime Preniqi tha se do tē ishte mirë që edhe nē bashkësítë lokale tē jenë tē sistemuara edhe femrat nē pozitat udhëheqëse, kështu që pse mos tē jetë një femër edhe kryetare e bashkësisë lokale, kështu që kjo temë mund tē jetë nē rend tē ditës nē mbledhjet e radhës së komitetit.

Violeta Salihu, kryesues tha se do tē ishte mirë që tē mbahet një seancë e organizuar nga kryetari apo nënkyetarja dhe tē diskutohet se çka është bërë rreth punësimit tē grave, pra sa janë tē punësuar nga gjinia mashkulllore, sa nga gjinia femërore, nē çfarë pozita etj.

Leonora Shabani-Bajraktari kérkoi tē dijë se ne si komitet a kemi tē drejtë tē kérkojmë prej burimeve njerëzore se sa gra janë tē punësuara kur i krahasojmë me burrat nē Komunën e Prishtinës, pa i futur mësueset dhe pa i futur infermieret vetëm nē objektet e Komunës.

Premtime Preniqi, sa i përket punësimit tē gjinisë femërore nē Komunë tha se shumë pak dallon numri me tē punësuarit meshkuj.

Besart Krasniqi tha se nē Komunë gjithmonë ka pasur nē sportete femra më shumë, sidomos nē shërbimin te tatimi nē pronë.

Violeta Salihu, kryesuese tha se nē muajin mars, nē javën e gruas mendoj se do tē ishte mirë që ta kemi një seancë me temën rreth rolit tē gruas nē shoqëri, apo ndonjë dokumentar ose një mbrëmje poetike. Po ashtu edhe nē muajin prill mund ta organizojmë një tryezë pér rendësinë e promovimit tē gruas nē politik nē nivelin lokal. Po ashtu më vonë nē korrik- tetor me asociacionin e gazetarëve, kështu që tì ftojmë ndonjërin prej gazetarëve, sepse edhe këta gazetar nuk i promovojnë gratë nē politikë dhe tē dalim me një konkluzion së bashku me ta.

Faqe3nga4

Leonora Shabani-Bajraktari tha se është mirë që Komiteti për Barazi Gjinore në bashkëpunim me grupin e grave asamblistë, ta ketë një takim ku është edhe OSBE-ja që i ofrojnë trajnime për gratë asamblistë, e që jam e sigurte që shumica prej tyre nuk e dinë çka është buxhetimi i përgjegjshëm gjinor.

Premtime Preniqi tha se në muajin janar janë në program disa trajnime dhe mendoj se gratë asambliste do ti ftoj që të marrin pjesë në një trajnim përfshi eficiencën.

Violeta Salihu, kryesuese tha se sa i përket rishikimit të buxhetit është mirë të flasim pastaj çka mund të bëjmë, me shikuar çfarë projekte mund të qojmë përpara, kur është koha e subvencioneve, ku mund ti përkrahim gratë më shumë, ndoshta edhe tek punësimi, tek projektet.

Besart Krasniqi tha se ne si komitet a mund të kemi ndikim që me e mundësuar ndonjë trajnim për gratë sidomos ato që kanë dhunë në familje, t'i integrojmë si psh. në ndonjë trajnim përfshi frizerka ose rrobaqepësi që nesër, pasnesër të pavarësohen prej atyre trajnimeve.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se tek buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është më mirë që p.sh me e shty Komunën që secila rrugë që ndërtohet ta ketë trotuarin d.m.th. ajo është që a na dëgjon dhe a mund ta bëjmë, por aty duhet ta planifikojmë, që jo vetëm rruga por duhet të ketë edhe trotuar edhe ndriçim.

Violeta Salihu, kryesuese tha se të gjitha këto sugjerime dhe propozime do ti inkorporojmë në Planin e punës së komitetit përfundim 2023.

Mbledhja përfundoi në ora 17:15

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesja e Komitetit
Violeta Salihu



Faqe4nga4